

**Vendim nr. 259 datë 22.10.2025**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

|                      |          |
|----------------------|----------|
| Holta Zaçaj,         | Kryetare |
| Marsida Xhaferllari, | Anëtare  |
| Genti Ibrahimi,      | Anëtar   |

në datën 22.10.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (I) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** ILIR MUZHAQI

**OBJEKTI:** Deklarimi i vendimit nr. 00-2025-282, datë 18.02.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 71 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar materialin kallëzues penal nr. 2454, datë 27.10.2020, të paraqitur nga kallëzuesi Ilir Muzhaqi (*kërkuesi*). Në kallëzim është pretenduar se pas transferimit të kërkuesit në vitin 2018 nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (*IEVP*) Fier në atë Peqin, ai i ka kërkuar drejtuesit të institucionit që t'i komunikojë dinamika e vuajtjes së dënimit dhe vetëm pas kërkesës së

gjashtë i është kthyer përgjigje me shkresën e datës 31.08.2018, ku i është bërë me dije se ndaj tij kishte katër vendime penale dhe nuk ishte e mundur të nxirrej dinamika e vuajtjes së dënimit pa u bërë bashkimi i tyre. Në kallëzim është pretenduar se, referuar kërkesave të nenit 10 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, pranimi i kërkuarit në IEVP-në, Peqin është bërë në kundërshtim me parashikimet ligjore, në mungesë të një urdhri ekzekutimi të prokurorit. Po kështu, është pretenduar se me vendimin e datës 06.03.2019 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka konstatuar se nga përlllogaritjet e vuajtjes së dënimit me burgim të dhënë me vendimin nr. 231, datë 30.05.2013, dënimi i kërkuarit ka përfunduar më 22.09.2017, proces në të cilin është paraqitur shkresa e datës 18.02.2019 të IEVP-së, Peqin, e cila përmban informacion për dinamikën e vuajtjes së dënimit, ku, sipas kërkuarit, ka elemente të falsifikimit, pasi dërgohet informacion për një vendim gjyqësor të vuajtur dhe të përfunduar.

2. Në lidhje me këtë kallëzim, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Kundër këtij vendimi kërkuar ka paraqitur ankim në gjykatë.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 838(13-2021-1135), datë 12.02.2021, ka vendosur rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal. Sipas asaj gjykate, nuk rezulton që nga punonjësit e IEVP-së Peqin të ketë konsumim të elementeve të veprës penale të shpërdorimit të detyrës, pra veprime apo mosveprime në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, të cilat të kenë shkelur të drejtat dhe interesat e kallëzuesit (kërkuarit), ndërkohë që mospërgjigja në kohë e kërkesave të tij drejtuar IEVP-së nuk përbën element të veprës penale. Po sipas asaj gjykate, edhe nëse të dhënat e shkresës të IEVP-së mund të rezultojnë të gabuara, bashkimi i dënimeve penale bëhet mbi bazën e vendimeve penale të formës së prerë dhe informacioni i drejtuesit të IEVP-së shërben si indicie për fillimin e procedurës, por nuk përbën element të veprës penale. Në vlerësimin e asaj gjykate, pretendimet e kërkuarit janë të karakterit administrativ dhe nuk ngrihen në kushtet e përgjegjësisë penale. Kundër këtij vendimi kërkuar ka paraqitur ankim.

4. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2021-1087 (180), datë 16.06.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, pasi i ka gjetur të pabazuara shkaqet e ngritura në ankim dhe të drejtë arsyetimin e vendimit objekt ankimi. Kundër këtij vendimi kërkuar ka paraqitur rekurs.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2025-282, datë 18.02.2025, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi ka vlerësuar se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP). Sipas atij kolegji, nuk evidentohen shkelje të ligjit material ose procedural me pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit objekt rekursi apo që këto shkelje të jenë të tilla që të kenë

ndikuar në dhënien e vendimit, si dhe nuk evidentohet që vendimi të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

6. Në datën 05.06.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 14.07.2025.

7. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periodha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

## II

### Pretendimet e kërkuetit

8. **Kërkueti**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, në drejtim të:

8.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se nuk ka shkaqe ligjore, nuk ka vërejtur dhe nuk ka vlerësuar mbi shkaqet kundërshtuese të parashtruara në rekurs që lidhen me zbatimin e gabuar të ligjit procedural, pasi ankimi në gjykatë paraqitet për hetime të kryera nga prokuroria dhe jo për të vlerësuar vetë gjykata nëse ka ose jo elemente të veprës penale, siç ka ndodhur në rastin konkret.

8.2. *Parimit të paanshmërisë në gjykim*, pasi në përbërje të trupit gjykues në gjykatën e apelit kanë marrë pjesë gjyqtarët I.D. dhe A.M., të cilët kanë qenë në kushte papajtueshmërie, pasi kanë shqyrtuar me dhjetëra kërkesa të paraqitura nga kërkueti, por ky pretendim është konsideruar nga Kolegji Penal i pambështetur në prova, ndërkohë që është vetë gjykata që grumbullon provat e parashtruara, sipas nenit 193 të KPP-së.

8.3. *Së drejtës së mbrojtjes*, pasi Kolegji Penal, edhe pse ka vërejtur se seanca ankimuese në gjykatën e apelit, që është edhe ajo e dhënies së vendimit, është zhvilluar në prani të një mbrojtësi kryesisht, pa parashtruar mbi arsyen e mungesës dhe mospjesëmarrjes së kërkuetit në atë seancë, nuk e ka marrë në konsideratë këtë pretendim.

8.4. Vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës, edhe pse në dosjen gjyqësore rezulton i nënshkruar nga anëtarët e trupit gjykues, kopja e dorëzuar kërkuetit nga administrata gjyqësore është i panënshkruar nga ata. Edhe pse kjo faktori se

veprimet e administratës gjyqësore janë me dy standarde, Kolegji Penal nuk ka hetuar për këtë pretendim të ngritur në rekurs dhe të konstatuar edhe prej tij.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuarin. Në këtë drejtim, mospërbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

11. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kriter që ka të bëjë me natyrën dhe përmbajtjen e pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, Kolegji vëren se kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt në disa aspekte të saj. Kështu, në drejtim të së drejtës së aksesit, kërkuari ka pretenduar se edhe pse shkaqet e parashtruara në rekurs lidhen me zbatimin e gabuar të ligjit procedural sipas nenit 432 të KPP-së, për shkak se gjykatat e zakonshme nuk kanë verifikuar për hetimet e kryera nga prokuroria, por nëse ka pasur ose jo elemente të veprës penale, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk i ka vërejtur ato, nuk i ka marrë në konsideratë, por ka vendosur mospranimin e rekursit si të pabazuar.

12. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në kuptim të sa më sipër, Kolegji vëren se pretendimet e kërkuarit në këtë drejtim kanë natyrë thelbësisht ligjore, pasi kanë të bëjnë me zbatimin e gabuar të ligjit material dhe procedural nga gjykatat e zakonshme. Gjykata e Lartë, në funksion të së drejtës së aksesit në atë gjykatë, i ka verifikuar pretendimet e ngritura në rekurs dhe në përfundim ka vlerësuar se ato janë të pabazuara në kuptim të nenit 432 të KPP-së. Vendimi i Kolegjit Penal nuk rezulton të jetë alogjik dhe të ketë kundërthënie, ndërsa pjesa arsyetuese e tij lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv, duke plotësuar kështu edhe kërkesat për një vendim gjyqësor të arsyetuar. Kolegji thekson se Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj si gjykatë e ligjit, ndërkohë që vetëm fakti se ajo ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit, nuk është i mjaftueshëm në nivel kushtetues për të vënë në dyshim vendimmarrjen e saj. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit është haptazi i pabazuar.

14. Kërkuari ka pretenduar edhe cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, për shkak se në përbërje të trupit gjykues në gjykatën e apelit kanë marrë pjesë gjyqtarët I.D. dhe A.M., të cilët kanë shqyrtuar më parë dhjetëra kërkesa të paraqitura prej tij. Kolegji vëren se edhe pse kërkuari ka barrën e provës në këtë drejtim, ai nuk ka paraqitur as argumente, as ndonjë akt provues, apo të dhënë për të mbështetur pretendimin e tij, si më sipër. Kërkuari nuk ka arritur të provojë se proceset gjyqësore në të cilat pretendohet prej tij se kanë marrë pjesë më parë dy gjyqtarët e gjykatës së apelit kanë të bëjnë me shqyrtimin në fakt të së njëjtës çështje gjyqësore, çka të ketë krijuar një dyshim të justifikuar se vendimi i dhënë prej tyre në rastin konkret ka qenë produkt i një procesi të njëanshëm. Për më tepër, Kolegji vlerëson se ky

pretendim është marrë në shqyrtim nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili gjithashtu ka vlerësuar se ky argument/pretendim teorik, i pashoqëruar me prova, nuk është i mjaftueshëm për të motivuar një pretendim të tillë, pasi nuk konfigurron asnjë nga situatat ose shkaqet që parashikohen në nenet 15, 16 dhe 17 të KPP-së (*shih paragrafin 14 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuarit është haptazi i pabazuar.

15. Në drejtim të së drejtës së mbrojtjes, kërkuari ka pretenduar se seanca ankimese në gjykatën e apelit është zhvilluar në prani të një mbrojtësi kryesisht pa u parashtruar arsyet e mungesës dhe të mospjesëmarrjes së kërkuarit në atë seancë, ndërkohë që Kolegji Penal, edhe pse e ka konstatuar një fakt të tillë, nuk e ka marrë në shqyrtim atë. Kolegji vëren se, në rastin konkret, kërkuari ka qenë pala që ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe përmes akteve të ankimit ai ka pasur mundësinë të parashtronte pretendimet e tij për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të faktit. Nga ana tjetër, kërkuari nuk ka parashtruar asnjë argument dhe as nuk ka paraqitur ndonjë provë lidhur me (mos)njoftimin e tij për seancën nga sekretaria gjyqësore ose (pa)mundësinë për zgjedhjen e një mbrojtësi dhe as se avokati i caktuar kryesisht nuk ka ofruar një mbrojtje efektive apo se ka vepruar në atë seancë në kundërshtim me interesat e kërkuarit. Për rrjedhojë, vetëm ky fakt nuk është i mjaftueshëm në këndvështrimin kushtetues për të vënë në dyshim atë proces gjyqësor. Nga ana tjetër, as vetëm fakti se Kolegji Penal nuk është shprehur për këtë pretendim, i cili, nga ana tjetër, është pasqyruar si i tillë në vendimin e asaj gjykate, nuk është i mjaftueshëm për të vënë në dyshim atë proces nga pikëpamja kushtetuese, për sa kohë që në jurisprudencën kushtetuese është pranuar se vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto kushte, Kolegji vlerëson se edhe ky pretendim është haptazi i pabazuar.

16. Kolegji vlerëson se edhe për pretendimin se vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës i është dorëzuar nga administrata gjyqësore i panënshkruar, kërkuari nuk ka argumentuar në aspektin kushtetues cenimin e një të drejte kushtetuese për këtë shkak, në kushtet kur atij i është vënë në dispozicion vendimi gjyqësor sipas rregullave procedurale dhe ai ka pasur mundësi të ushtrojë të drejtat që i garanton legjislacioni procedural penal, në këtë rast të drejtën e paraqitjes së rekursit ndaj atij vendimi. Për më tepër, referuar arsyetimit të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nga aktet e dosjes gjyqësore konstatohet se vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës është i nënshkruar rregullisht nga të gjithë gjyqtarët që kanë përbërë trupin gjykues që ka gjykuar këtë çështje (*shih paragrafin 13 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Për rrjedhojë, për sa kohë që kërkuari nuk ka arritur të provojë, në këndvështrimin kushtetues,

se për këtë shkak procesi gjyqësor i kundërshtuar është arbitrar dhe se nuk respekton elementet e një gjykimi të drejtë, edhe ky pretendim është haptazi i pabazuar.

17. Për sa më sipër, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.